

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ- Departamenti i Pergjithshem- Divizioni Civil, me gjyqtarin Enes Mehmeti dhe procesmbajtësen Minrie Krasniqi, ne ceshtjen e inicuar me padine e paditesit [redacted] nga Ferizaji [redacted], të cilin e përfaqëson av. [redacted] nga Ferizaj, kundër të paditurit [redacted] më parë nga Ferizaji tani me adresë të panjohur, të cilin e përfaqëson përfaqësuesja e përkohshme av. [redacted] nga Kaçaniku, për vërtetim pronësie, ne séance e mbajtur me date 12.06.2017, merr kete:

AKT GJYKIM

- ne baze te pohimit -

- I. **APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit [redacted] nga Ferizaj dhe **VËRTETOHET** se paditësi është pronare i paluajtshmerisë me numër të njësisë kadastrale [redacted] [redacted], vendi i quajtur [redacted], me sipër. 534m², në zonën kadastrale Ferizaj.
- II. **OBLIGOHET** i padituri [redacted] që paditësit t'ia njoh te drejtën e pronësisë mbi këtë pronë dhe të i lejoj regjistrimin e saj ne regjistrat kadastral në emër të tij, këtë në afat prej 15 ditësh pas pranimit te kopjes së tij, në të kundërtën ky aktgjykim do t'i shërben paditësit si autorizim për të bërë regjistrimin e pronës në emër të tij.
- III. **OBLIGOHET** paditësi që të bëjë pagesën e pagesën e shpenzimeve për ekspert te gjeodezise në shumë prej 120, si dhe taksën gjyqësore për padi në shumë prej 225€ ne afat prej 15 ditësh pas pranimit te ketij aktgjykimi.

Arsyetimi

Paditesi me padi ka pretenduar se në vitin 1982, me të paditurin ka arritur marrëveshje gojore për shitblerjen e paluajtshmerisë [redacted] vendi i quajtur [redacted], me sipër. 534m², në zonën kadastrale Ferizaj dhe të njejtën paluajtshmeri në bazë të kësaj marrëveshje paditësi i ka paguar në tërësi çmimin e shitblerjes dhe i padituri si pronar legjitim menjëherë i ka

7
VAC

dorëzuar në posedim faktik këtë kësaj paluajtshmërie objekt kontesti. Po ashtu ka theksuar se me rastin e pagimit të çmimit të kontraktuar të shitblerjes prezent ka pasur dëshmitarë të cilët mund të vërtetojnë këtë fakt lidhur me shitblerjen e kësaj paluajtshmërie, andaj ka kërkuar që ti njihet e drejta e pronësisë mbi këtë paluajtshmëri në bazë të posedimit me mirëbesim.

Gjykata, fillimisht, ka aprovuar propozimin e paditësit që të paditurit t'i caktohet perfaqesuesi i perkohshem, meqenese i njejti është shpërngulur jashte Kosoves dhe se paditësi e ka të pamundur për të siguruar të dhëna lidhur me adresën e të paditurit.

Gjykata aktvendimin per caktimin e perfaqesuesit te perkohshem e ka publikuar ne gazeten zyrtare te Republikes se Kosoves dhe ne tabelen e shpalljeve te kesaj gjykate.

Përfaqësuesja e perkohshme perkohshëm av. [REDAKTUAR] nga Kaçanik, në përgjigjen në padi ka kontestuar kërkesë padinë e paditësit në tërësi si të pa bazuar.

Paditësi përmesë të autorizuarit të tij gjatë shqyrtimit të çështjes si dhe në fjalën përfundimtare ka theksuar se mbetet në tërësi pranë theksimeve në padi dhe shton se në këtë procedurë janë administruar prova të vlefshme materiale dhe jo materiale që dëshmojnë faktin se paditësi ka blerë shtëpinë sëbashku me tokën nga i padituri [REDAKTUAR] këtë e konfirmon dëshmia me shkrim dhe dëshmia e dëshmitarëve të cilët kanë qenë prezentë direk me rastin e lidhjes së marrëveshjes dhe pagesës së çmimit të shitblerjes, andaj konsideroj se janë plotësuar kushtet ligjore për njohjen e të drejtës së pronësisë së paditësit mbi paluajtshmerin objekt kontesti.

Perfaqesuesja e perkohshme av. [REDAKTUAR] nga Kaçaniku, gjatë shqyrtimit të çështjes si dhe në fjalën e tij përfundimtare ka theksuar se në këtë çështje kontestimore u administruan prova të vlefshme materiale që provojnë themelsinë e padisë së paditësit. Nga marrëveshja me shkrim rezulton i provuar fakti se paditësi me të paditurin kanë pasur një marrëveshje të shitblerjes së paluajtshmerisë, objekt kontesti dhe se paditësi për këtë ka përmbushur në tërësi çmimin kontraktues, për cka dhe mbi këtë bazë ka hyrë në posedim të ligjshëm dhe me mirëbesim në shtëpi të të paditurit, paditësi në të jeton që nga ajo kohë pa asnjë pengesë nga i padituri dhe personal të tretë, andaj konsiderojë se paditësi duke qenë se mbi bazën e blerjes e ka marr në posedim paluajtshmerin objekt kontesti, posedimin e ka marr nga marrëveshja me të paditurin dhe i padituri i ka dorëzuar shtëpinë dhe paluajtshmerin në të cilën paditësi jeton që nga vitit 1982, pra mbi 20 vite, andaj konsiderojmë se pretendimet e padisë së paditësit janë të themelta.

1507/03.05.2017

Gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të pohuar duke qenë se në mes palëve ndërgjyqjësë nuk ishin kontestuese faktet vendimtare të çështjes dhe se i padituri respektivisht perfaqesuesi i perkohshëm shprehimisht ka pranuar kerkespadine dhe në anën tjetër, gjykata nga shqyrtimi i gjithmbarshëm i çështjes nuk ka gjetur ndonjë rrethanë, për të cilën duhet kujdesur kryesisht e cila do te pengonte aprovimin e kërkesëpadisë dhe rrethana tjera që t'i vënte në kundërshtim faktet dhe provat e çështjes me pohimin e kërkesëpadisë nga ana e përfaqësuesit të perkohshëm të të paditurit, ndaj ne kuptim te nenit 148 të LPK-së, ka nxjerr aktgjykim në bazë të pohimit.

Gjykata me qellim te vertetimi te rrethanave lidhur me poziten dhe shtrirjen e pronës kontestuese ka bere identifikimin e saj permes ekspertit te gjeodezise [REDACTED], me ane te te cilit ka percaktuar paramasat dhe kufizimet e pronës objekt kontesti, nga ku ka sqaruar sipërfaqen e pronës objekt konteskti, pozicionimin e saj- shtrirjen kadastrale ne zone, pronaren juridike të saj dhe shfrytëzuesin aktual te saj dhe per keto te gjetura te ekspertizes gjykata i ka pranuar ne teresi si professional dhe ne perputhje me gjendjen faktike dhe zyrtare për paluajtshmërin me numër [REDACTED], vendi i quajtur [REDACTED], me sipër. 534m², në zonën kadastrale Ferizaj, ekspertizë kjo e punuar me datën 23.05.2017.

Gjykata me qellim te vertetimi te rrethanave lidhur me shitblerjen e kësaj prone objekt kontesti ka dëgjuar dëshmitarët [REDACTED] dhe [REDACTED]

Dëshmitari [REDACTED] në dëshminë e tij ka sqaruar rrethnat lidhur me shitblerjen e kësaj paluajtshmërie ndërmjet paditësit dhe të paditurit, si dhe rrethanën se me paditësin ka punuar në Fabrikën e Gypave. Dëshmitari ka deklaruar se sëbashku me [REDACTED] dhe [REDACTED] kanë qenë bashkë në shtëpinë e të paditurit [REDACTED] kur [REDACTED] e ka bërë pazarë. [REDACTED] ka dhënë në kesh të gjitha paratë në prezencën tonë dhe i padituri [REDACTED] ka qenë shume i kënaqur me këtë dhe na ka qeras me nga një gotë raki, e gjithë kjo ka ndodhur në vitin 1980 në pranverë. Pas dy muajsh pasi që [REDACTED] i ka dhënë paratë [REDACTED] ai ka fillu me jetu në shtëpi, pasi që shtëpia nuk ka qenë në gjendje të mirë, [REDACTED] i ka thënë [REDACTED] që me bë një kontratë me [REDACTED] duke i thënë "bane për çdo rast".

Dëshmitari [REDACTED] në dëshminë e tij ka theksuar se me të paditurin [REDACTED] kanë qenë fqinjë të hershëm dhe se [REDACTED] shtëpinë e ka shitur në vitin 1980, këtë faktë e dinë mirë pasi që me të ka pasur raporte të afërta dhe e ka pasur fqinjësi të mirë me të. Për shitjen e shtëpisë [REDACTED] më ka treguar vetë, ka qenë sëbashku me dhëndërrin e tij [REDACTED] se shtëpinë i'a ka

shitur [REDACTED]. Pas kësaj unë kam shkuar te [REDACTED] dhe si fqinjë ia kam bërë përhapje shtëpinë e blerë. Po ashtu ka shtuar faktin se [REDACTED] aty jetonë që një kohë të gjatë pa asnjë pengesë apo shqetësim nga askush.

Gjyata po ashtu ka bërë edhe administrimin e provave të tjera si: Marrëveshjen e Palëve për shitblerjen e paluajtshmërisë obehjt kontesti, Mendimin e Ekspertit sëbashku [REDACTED]

[REDACTED] dhe dëshmitë e dëshmitarëve [REDACTED] dhe [REDACTED]. Gjykata ka obliguar paditësin që të paguaj shpenzimet shpenzimet e ekspertit të gjeodezisë në shumë prej 120€ në kuptim të nentit 451 të LPK-së, ndersa taksën gjyqësore për padi në shumë prej 225€ ne baze te nenit 445 te LPK-se.

Mbi bazën e parashtrimeve te mesiperme eshte vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

C.nr.550/11, me datën 12.06.2017



KËSHILLË JURIDIKE: Kunder ketij aktgjykimi mund te ushtrohet ankese ne afat prej 15 ditesh, pas pranimit te tij, ne Gjykatën e Apelit ne Prishtine, permes kesaj Gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC

Më
Dana

21. 08

20 17

